

Deklarata mbi Politikat Mjedisore te Grupit Volkswagen

Si një udhëheqës botëror në zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e automjeteve Grupi Volkswagen përpiqet të bëhet një ofruer kryesor i lëvizshmërisë së qëndrueshme dhe të jetë shembull për tu ndjekur në mjedis. Ne përqafojmë sfidat e ngrohjes globale dhe jemi të përkushtuar ndaj objektivit nr.2 të Kombeve të Bashkuara. Ne jemi të vetëdijshëm për ndikimin mjedisor dhe shoqëror që aktivitetet dhe produktet tona kanë në mbarë. Për të zvogëluar gjurmën tonë mjedisore, ne përdorim kapacitetin tonë inovativ për të trajtuar sfidat mjedisore në çdo hap të ciklit të jetës së produkteve tona. Risitë që ne sjellim në tregun automotiv do të ndihmojnë klientët tanë të zvogëlojnë gjurmët e tyre mjedisore, ndërsa ne njëkohësisht sigurojmë konkurueshmërinë e kompanisë dhe punësimin e kolegëve tanë.

Duke u mbështetur në "Vendimi mbi Misionin Mjedor", Grupi Volkswagen angazhohet për pikat e mëposhtme:

1. Menaxhimi

Menaxherët tanë, në çdo nivel të organizatës në të gjitha markat dhe kompanitë e Grupit Volkswagen, janë të vetëdijshëm për rreziqet mjedisore që aktivitetet tona të biznesit sjellin, dhe do të tregojnë me fjalë dhe në veprime, angazhimin e tyre për të vepruar sipas rregullave mjedisore. Ata janë përgjegjës për zbatimin e këtyre politikave në kompanitë që drejtojnë dhe duhet të sigurojnë që të gjithë punonjësit të jenë të informuar, të kualifikuar dhe të përgjegjshëm për detyrat e tyre. Bordi Menaxhues i Grupit dhe menaxhimi i çdo kompanie do të trajtojnë përgjegjësinë mjedisore në mënyrë të barabartë me kriteret e tjera të operimit të biznesit gjatë vendimarrjes në kompani.

2. Pajtueshmëria

Ne i përmbahemi kërkesave ligjore dhe rregullatore, si dhe standardeve dhe synimeve të kompanisë. Ne zbatojmë Sistemet e Menaxhimit për Pajtueshmërisë ndaj Mjedisit për të siguruar që detyrimet e kërkesave të mjedisit kuptohen dhe arrihen në operacionet tona të biznesit. Mashtrimi dhe sjellja jo korrekte ndaj mbrojtjes së mjedisit do të trajtohet si një shkelje e rëndë e pajtueshmërisë. Pajtueshmëria së bashku me Vendimin për Politikën Mjedisore dhe me kërkesat e Grupit për mbrojtjen e mjedisit do të vlerësohen periodikisht çdo vit dhe çdo kompani do të raportojë tek Bordi Menaxhues i Grupit.

3. Mbrojtja e mjedisit

Ne ndjekim një qasje të ciklit të jetës për të lehtësuar rreziqet mjedisore dhe për të optimizuar mundësitë mjedisore siç janë integrimi i burimeve të rinovueshme të energjisë, dekarbonizimi,

zinxhirët e furnizimit të qëndrueshëm dhe efikasiteti i burimeve. Ne zbatojmë metoda të vlefshme ekonomikisht për të ulur ndikimin tonë mjedisor përgjatë ciklit të operacioneve, produkteve dhe shërbimeve tona. Përpjekjet tona verifikohen çdo vit nga publikimi i treguesve kryesorë të performancës.

4. Bashkëpunimi i Stakeholders-ave

Ne angazhohemi me punonjësit tanë, rregullatorët, klientët, furnitorët, komunitetet, autoritetet publike dhe palët e tjera të interesuara për të përmirësuar të kuptuarin e kërkesave dhe detyrimeve mjedisore. Inputi i Stakeholders-ave konsiderohet dhe reflektohet në Sistemet e Menaxhimit për Pajtueshmërisë ndaj Mjedisit dhe në operacionet, produktet dhe shërbimet tona. Ne angazhohemi të ofrojmë informacion transparent dhe të besueshëm në komunikimin tonë dhe raportimin tek palët e interesit.

5. Përmirësimi i vazhdueshëm

Si pjesë e përpjekjes sonë për tu përmirësuar vazhdimisht, ne implementojmë sisteme të menaxhimit të mjedisit të njohura ndërkombëtarisht dhe të palëve të treta të verifikuara, të cilat integrojnë kërkime mjedisore në proceset tona kryesore të biznesit dhe vendimmarrjes. Po ashtu, vetë sistemet tona të menaxhimit të mjedisit i nënshtrohen një procesi të përmirësimit të vazhdueshëm. Ne mbështetemi në rrjetin tonë global të ekspertëve për të identifikuar dhe përshtatur praktikat më të mira në teknologjinë dhe menaxhimin e mjedisit. Ne qendrojmë në pararojë të zhvillimeve në praktikat mjedisore në rregullore, shkencë, teknologji dhe pritshmëritë e Stakeholders-ave për të përmbushur ose tejkaluar angazhimin tone.

Wolfsburg, May 2019

Dr. Herbert Diess Dr.

Oliver Blume